



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KOLONJË
DREJTORIA EKONOMIKE, E FINANCËS DHE BUXHETIT

PROJEKT-VENDIM

Nr. Datë .09.2025

PËR

MIRATIMIN E PROJEKT DOKUMENTIT TË PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESËM VENDOR
2026-2028

TË BASHKISË KOLONJË

Në mbështetje të ligjit nr. 139/2015 “Për qeverisjen vendore” neni 54 “Detyrat dhe kompetencat e Këshillit Bashkiak “ gërma dh, ligji nr 9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” neni 32 “Përgatitja dhe miratimi i buxheteve vendore” ligji nr 68/2017 ‘ Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore” shkresën e Ministrisë së Financave nr. prot ,4074/1 datë 04.03.2025 “Dërgohet Udhëzimi për përgatitjen e programit buxhetor Afatmesëm vendor 2026-2028, “Udhëzimi nr 8 ,datë 28.02.2025 “Për përgatitjen e programit buxhetor Afatmesëm Vendor 2026-2028”, VKB nr.135 datë 23.12.2024 “Për miratimin e kalendarit për programin afatmesëm 2026-2028 dhe buxhetin vjetor 2026”, VKB nr.4, datë 30.01.2025 “Për miratimin e raportit të vlerësimit dhe parashikimit afatmesëm të të ardhurave 2026-2028”, shkresën e Ministrisë së Financave nr.9739 prot.datë 18.06.2025 “Dërgohen mendimet mbi Programin Buxhetor Afatmesëm 2026-2028”, VKB nr.88, datë 17.07.2025 “Për miratimin e Tavanëve Buxhetore Përfundimtare të programit buxhetor afatmesëm vendor 2026-2028 të Bashkisë Kolonjë”, me kërkesë të kryetarit të Bashkisë Kolonjë.

I propozoj Këshillit të Bashkisë Kolonjë në mbledhjen e tij të datës __, __, 2025

1. Të miratojë projekt-dokumentin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2026-2028 të përgatitur nga Drejtoria e Financës dhe nga Ekipet e Menaxhimit të Programeve Buxhetore.
2. Dokumentat shoqëruese të projekt-dokumentit të PBA-së janë:
Relacioni shpjegues mbi përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm së bashku me kërkesat buxhetore sipas programeve buxhetore.
Tabelat e PBA- së 2026-2028 Faza II, të gjeneruara nga SMBV (sistemi i menaxhimit të buxhetit vendor) , platformë online e ndërtuar nga Ministria e Financave.
Dëgjuesat Publike shtator 2025
3. Për zbatimin e këtij projekt-vendimi ngarkohet Drejtoria e Financës dhe administrata e Bashkisë Kolonjë.
4. Ky projekt-vendim hyn në fuqi pas miratimit nga Prefektura.

KRYETARI

Erion Isai



NËN/KRYETAR

Petro Risto



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KOLONJË

Nr. ____ Prot

Dt. ____ / ____ /2025

RELACION
PËR
PROJEKT-VENDIM

Nr. Datë .09.2025



BASHKIA KOLONJË

PROJEKT DOKUMENTI

PROGRAMI BUXHETOR AFATMESËM
2026 - 2028

Shtator 2025

1. HYRJE

Roli dhe Qëllimi i Programit Buxhetor Afatmesëm, si një Instrument Efektiv Planifikimi në Nivel Vendor

Programi Buxhetor Afatmesëm (PBA) është një instrument për prezantimin në mënyrë të integruar e disavjecare të parashikimit të të ardhurave dhe burimeve financiare publike dhe për planifikimin, manaxhimin dhe lëvrimin e shërbimeve publike. Si i tillë, ai është një komponent kryesor i planifikimit kombëtar dhe vendor.

Strategjia Kombëtare e Zhvillimit, Strategjitë Sektoriale dhe Planet e Përgjithshme Vendore shpjegojnë atë që qeveria synon të arrijë në fushat kryesore të ofrimit të shërbimeve, cilat struktura të qeverisë do të përfshihen dhe si do të ndërveprojnë me organizatat e sektorit privat dhe aktorë të tjerë joqeveritarë. Si të tilla, ato përshkruajnë mënyrën sesi qeveria synon të zhvillojë komponentët kryesorë të ofrimit të shërbimeve, investimet kryesore publike që do të kërkojnë dhe implikimet përkatëse për nivelin dhe llojin e shërbimeve publike që do të ofrohen. Aspekti strategjik i këtyre dokumenteve i jep formë kërkesave për shpenzime për investime publike si dhe për ofrimin e shërbimeve gjatë periudhave disavjecare.

Ashtu si edhe nivelet e tjera të qeverisjes, Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore (NJVQV-të) janë përgjegjëse për menaxhimin e fondeve publike. Kjo përfshin mbledhjen e taksave dhe tarifave vendore dhe menaxhimin e burimeve kombëtare që transferohen në bashki nga qeveria qendrore, disa prej të cilave kushtëzohen për shërbime specifike. Kjo do të thotë se kërkohet një instrument për të projektuar burimet e përgjithshme të disponueshme për shpenzimet vendore, duke përfshirë këtu: grantet, huatë, taksa e tarifat vendore dhe transferime nga qeveria qendrore (të kushtëzuara dhe të pakushtëzuara).

Njësitë e vetëqeverisjes vendore ofrojnë shërbime publike vendore bazuar në kompetencat që u jep ligji. Si rrjedhojë, kjo kërkon një instrument për të lehtësuar dhe menaxhuar mënyrën e përdorimit të burimeve gjithsej, duke përfshirë vendimet për llojin e shpenzimeve (pagat dhe sigurimet; mallrat dhe shërbimet, interesat e borxhit, ripagimi i huave dhe kështu me radhë), si dhe vendimet strategjike se si do të alokohen burime midis llojeve të ndryshme të shërbimeve publike (sigurisë publike, arsimit, shëndetësisë, punëve publike dhe kështu me radhë).

Procesi i PBA-së, prezanton në mënyrë të integruar informacionin mbi parashikimet e të ardhurave dhe burimeve gjithsej dhe përcakton objektivat përse do të shpenzohen ato, kostot e nevojshme dhe llojin e secilit shërbim që do të ofrohet. Ndër të tjera, kjo përfshin lidhjen e qëllimeve dhe objektive të bashkisë me qëllime strategjike të përcaktuara në strategjitë lokale dhe kombëtare. Procesi i PBA-së, disiplinon maturinë financiare vendore duke planifikuar shpenzimet publike brenda një kuadri realist financiar vendor. Në të njëjtën kohë, ai synon të garantojë që shërbimet publike vendore plotësojnë nevojat në rritje të banorëve duke treguar se si shpenzimet publike për prioritetet strategjike të zhvillimit të njësive vendore përkthehen në vendime konkrete për ofrimin e shërbimeve publike vendore, me lidhje të qarta mes politikave vendore dhe prioritetëve vjetorë të shpenzimeve .

Në procesin e PBA-së planifikimi dhe buxheti vendor afatgjatë e ndihmon njësinë vendore të planifikojë sesi shërbimet publike do të evoluojnë me kalimin e kohës, duke përcaktuar kërkesat disavjeçare të shpenzimeve në fusha të ndryshme të ofrimit të shërbimeve në përputhje jo vetëm me ndryshimet e parashikuara në demografinë, por edhe në përputhje me ndryshimin e nevojave të banorëve të bashkisë. Kombinimi i këtij informacioni me parashikimin për nevojat dhe burimet në dispozicion në të ardhmen, u mundëson njësinë vendore që të planifikojnë shërbime publike në mënyrë të qëndrueshme, si dhe të zhvillojnë një kuadër afatmesëm të burimeve si bazë për planifikimin afatmesëm të shpenzimeve.

Programi Buxhetor Afatmesëm si një instrument operacional për menaxhimin e shpenzimeve publike dhe një komponent kyç i Sistemit të planifikimit të integruar, është hartuar bazuar në:

1. Rishikimi i politikave

2. Planifikimi i shpenzimeve dhe investimeve të programit .

Programi Buxhetor Afatmesëm është :

- I balancuar
- Transparent
- Afër Komunitetit
- Efiçent
- Efektiv
- I matshëm
- Produktiv
- I krahasueshëm
- Barazi në shpërndarje
- Gjithpërfshirës
- Koherent
- I përgjigjshëm gjinor

Programi Buxhetor Afatmesëm është hartuar mbi :

- Analizën e realizimit të treguesve të vitit 2024, realizimin e pritshëm të vitit 2025.
- Përqasjen me prioritetet e miratuara në PPV e bashkisë .
- Takimet publike të Kryetarit me komunitetin .
- Kërkesat e marra nga takimet e Kryetarit me grupet e interesit .

➤ Për kë është ky projektbuxhet

- Për 17410 banorë
- Për 6559 familje
- Për 864 km²
- Për 5 Njësi Administrative dhe 2 qytete , Ersekë dhe Leskovik .
- Për 253 të punësuar në bashki nga të cilat 105 Gra dhe 148 Burra
- Për 15 këshilltarë nga të cilët 7 gra dhe 8 burra
- Për 53 administratorë të fshatrave
- Për 325 biznese nga të cilat 88 biznese janë të drejtuara nga gra .

- Për 7 biznese të reja të hapura në vitin 2025 nga te cilat 2 fizikë dhe 5 biznese juridikë.
- Për 2105 familje në qytet që paguajnë tarifa pastrimi dhe ndriçimi dhe 1060 familje në njësitë administrative që paguajnë tarifa pastrimi dhe 1248 familje po në njësitë administrative që paguajnë tarifa ndriçimi.
- Për mesatarisht 7-10 nxënës ekselentë në vit
- Për rastet e ndërhyrjes për shpëtimin e jetëve dhe ndërhyrjet për shuarjen e zjarreve .
- Për ndërhyrjet emergjente të ndodhura sipas rasteve .

- Për 11.210 ha tokë bujqësore , sipërfaqe toke e kultivuar 5250 ha , nr i parcelave të tokës bujqësore 32642 .
- Për 10 gra që do fillojnë punën në inkubatorin "Gratë Duararta të Leskovikut"
- Për 450 shërbime ndaj fermerëve .
- Për 4 prita mesatarisht në vit mbrojtëse ndaj erozionit dhe përmytjeve për rreth 120 familje bujqësore .
- Për 2303 ferma të vogla bujqësore .
- Për 120.7 ha tokë bujqësore të dhënë me qira.
- Për 970 familje bujqësorë për vaditje nga të cilat 74 familje me gra kryefamiljare me 520 ha të vaditura .
- Për 80 km rrjet ujitës të mirëmbajtura .
- Për 55 km rrjet kullues të mirëmbajtur.
- Për 18 rezervuarë funksionale .
- Për 170 familje bujqësore për sipërfaqet e kulluara , me 160 ha të kulluara
- Për mirëmbajtjen e 24 ujëmbledhësve .

- Për 130 km rrugë rurale .
- Për ndërhyrjet emergjente në njësitë administrative

- Për 50,783 ha pyje dhe 21.742 ha kullota
- Për furnizimin me dru zjarri të popullatës
- Për 1350 ton mbetje të përpunuara nga 1500 ton të grumbulluara në total .
- Për hartimin e projekteve dhe preventivave sipas prioriteteve

- Për 2000 m2 trotuarë për tu riparuar .
 - Për përfundimin e ndriçimit LED në qytetet Ersekë dhe Leskovik .
 - Për mirëmbajtjen 20553 m2 sipërfaqe të gjelbëruara .
 - Për mirëmbajtjen e varrezave të dëshmorëve, martirëve dhe publike 26.185 m2 në qytet 70.000 m2 në fshat.
-
- Për aktivitetet sportive të nxënësve të kopshteve, shkollave, të 5 ekipeve zinxhir të futbollit, volejboll , basketboll për 2 ekipe vajzash dhe 2 ekipe djemsh .
 - Për mirëmbajtjen dhe rehabilitimin e ambienteve sportive për fëmijët dhe rininë.
-
- Për rreth 35 mijë turistë dhe 50 mijë vizitorë.
 - Për mesatarisht 16 biznese të reja të hapura me pagesën e sigurimeve shoqërore nga të cilat 5 biznese të reja drejtohen nga gra .
 - Për 15 aktivitete kulturore-artistike, për rreth 600-700 pjesëmarrës me performues 7 të punësuar dhe 50-60 performues të jashtëm, ku 60% janë meshkuj 40% femra .
 - Për 4 aktivitete të përbashkëta kulturore-artistike-turistike.
 - Për 10 aktivitete turistike.
 - Për 50-60 biznese të cilët përfitojnë nga aktivitetet kulturore –artistike dhe turistike .
-
- Për 783 nxënës nga të cilat 358 nxënëse dhe 425 nxënës në arsimin e mesëm dhe 9-vjeçar .
 - Për 124 mësues nga të cilat 76 mësuese dhe 47 mësues dhe për 28 edukatore.
 - Për 165 fëmijë në kopshte nga të cilët 83 vogëlushe dhe 82 vogëlushë .
 - Për fëmijët sipas grupmoshave 3 vjeçarë 38 fëmijë , 4-vjeçarë 58 fëmijë , 5 vjeçarë 60 dhe 6 vjeçarë 9 fëmijë .
 - Për 19 shkolla dhe 3 kopshte dhe 9 kopshte në varësi të shkollave , duke siguruar pastrimin –disinfektimin , ngrohjen , mirëmbajtjen , etj.
 - Për 22 fëmijë në çerdhe , 15 vogëlushe dhe 7 vogëlushë, sipas grupmoshave fëmijë 1-vjeçar 1, 2-vjeçarë 19 dhe 3-vjeçarë 2 fëmijë.
 - Për kopshtin e ri me drekë i cili do të fillojë funksionimin nga viti 2025 (i munguar ky shërbim prej më shumë se 20 vitesh .
 - Për 10 aktivitete që organizohen me fëmijët e kopshteve .
 - Për 23 aktivitete të organizuara ng QKF në bashkëpunim me kopshtet dhe shkollat 9-vjeçare të bashkisë.
 - Për promovimin e 7-10 talenteve të reja në vit në pikturë , këngë dhe instrument

- 14 nënësve të akomoduar në konviktin Ersekë.
- Për 224 familje me ndihmë ekonomike nga të cilat 12 me gra kryefamiljare dhe 212 me burra.
- Për 5 viktime të dhunës në familje nga të cilat trajtohen me ndihmë ekonomike ,nga të cilat 4gra dhe 1 burrë.
- Për 10 persona të trajtuar me status jetimi nga të cilat 4 janë vajza dhe 6 djem
- Për 261 invalide (pak + paraplegjike + tetraplegjikë + verbëri) nga të cilët 121 gra dhe 140 burra .
- Për 14 familje të cilat trajtohen me bonus strehimi , nga të cilat 3 janë gra.
- Për 14 familje përfituese nga projekti i përmirësimit të kushteve të banimit.

Hapat që janë ndjekur për përgatitjen e Dokumentit të PBA-së 2026-2028.

Në përputhje me nenet 4 dhe 24 të Ligjit nr, 9936, datë 26.06.2028 “ Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë “ i ndryshuar , ligjin nr.68, datë 27.04.2021” Për financat e vetëqeverisjes vendore “ si dhe Udhëzimit nr . 23, datë 30.07.2018 “ Për procedurat standarte të programit buxhetor afatmesëm të njërive të vetëqeverisjes vendore “ i ndryshuar Bashkia Kolonjë për hartimin e draftit të parë të PBA-se 2026-2028 ka ndjekur hapat si më poshtë:

1. *Me Vendimin e Këshillit të Bashkisë nr 4, datë 30.01.2025 është miratuar raporti i vlerësimit dhe parashikimit afatmesëm të të ardhurave të veta . Ky parashikim është diskutuar dhe në takimin e GMS-së i ngritur me urdhërin nr 2 , datë 06.01.2025 të organizuar në datën 17 janar 2025.*
2. *Në datën 04.03.2025, protokolluar me tonën prot nr 1173, datë 05.03.2025 , Bashkia është njohur me Udhëzimin nr 8 “Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm vendor 2026-2028”. Pas kësaj date filloi puna për përgatitjen e tavanëve buxhetore afatmesme . Tavanet buxhetore 2026-2028 u diskutuan në takimin e GMS-së të datës 10 mars 2025.Tavanet buxhetore u përgatitën në zbatim të udhëzimit nr. 8 duke bërë grupimin në 17 programe buxhetore .*
3. *Me VKB nr .37, datë 13.03.2025 të Këshillit të Bashkisë Kolonjë u miratuan tavanet përgatitore të programit buxhetor afatmesëm vendor 2026-2028 të Bashkisë Kolonjë, miratuar me shkresën nr 319/1 prot ,datë 01.04.2025 të prefektit të Qarkut Korçë.*
4. *Me urdhërin nr.115 datë 20.03.2025 ,protokolluar me nr.1437,“ Për Hartimin dhe zbatimin e Udhëzimit për hartimin e kërkesave buxhetore të PBA-së 2026-2028 në zbatim të VKB nr 37, datë 13.03.2025 janë ngritur ekipet e menaxhimit të programeve për 17 programe buxhetore,janë përcaktuar afatet e dorëzimit të kërkesave buxhetore , është shpërndarë urdhëri në të gjithë drejtuesit e EMP, bashkalidhur urdhërit ishin tavanet buxhetore të miratuar me VKB nr 37.Gjithashtu theksojmë se i gjithë dokumentacioni ju është dërguar dhe në rrugë elektronike të gjithë drejtuesve të EMP-ve.*

5. *Gjatë muajit prill, EMP-të kanë përgatitur kërkesat buxhetore. Pas dorëzimit nga EMP-të të kërkesave buxhetore filloi puna për hartimin e instrumentit. Në mbledhjen e datës 28.04.2024 GMS-ka vlerësuar dhe miratuar kërkesat buxhetore.*
6. *Gjatë muajit maj Drejtoria e Financës së bashku me EMP-të punoi për të përgatitur Projekt-Dokumentin e PBA-së faza e parë.*
7. *Drafti i parë brenda muajit maj dërgohet në Ministrinë e financave dhe Ekonomisë.*
8. *Me VKB nr.74 dt.30.06.2025 të Këshillit të Bashkisë Kolonjë ,miratohet Drafti i Parë i PBA-së 2026-2028 ,sipas udhëzimit nga Ministria e Financave.*
9. *Me VKB nr.88, datë 17.07.2025 të Këshillit të Bashkisë Kolonjë u miratuan tavanet përfundimtare të programit buxhetor afatmesëm vendor 2026-2028 të Bashkisë Kolonjë,*
10. *Në muajin shtator 2025 u bënë dëgjesa publike me komunitetin për PBA 2026-2028 dhe Buxhetin 2026. Kalendari i Dëgjësive është i publikuar edhe në faqen web të Bashkisë.*

1. Vështrim i përgjithshëm.

1.1 Situata e njësive të vetëqeverisjes vendore

- Bashkia Kolonjë është pjesë e Qarkut të Korçës dhe kufizohet me Bashkinë Korçë, Devoll , Skrapar dhe Përmet.
- Ka një sipërfaqe 864 km² , popullsi 17.410 banorë dhe 6.559 familje
- Ajo përbëhet nga 5 Njësi Administrative (NJA):
- Ersekë, Njësi Qëndër Ersekë , Mollas - Çlirim , Novoselë - Barmash , Leskovik Qëndër dhe Leskovik .
- Në përbërje të tyre këto NJA përfshijnë gjithsej 2 qytete Ersekë dhe Leskovik si dhe 3 njësi administrative me 74 fshatra në total . Popullsia është shpërndarë në gjithë territorin e Bashkisë ku dendësia më e madhe është në qytetin e Ersekës dhe Leskovikut të cilat përfaqësojnë 48 % te popullsisë të Bashkisë Kolonjë . Ky përqendrim i popullsisë rrjedh si nevojë e komunitetit për akses ndaj shërbimeve mes qendrave urbane, poleve ekonomike të vendit etj..

Familjet.

Bashkia Kolonjë përbëhet nga 6.559 familje e ku peshën më të madhe e zë Qyteti i Ersekës dhe Leskovikut me 2.661 familje ose 40.57%.

Aktualisht trajtohen me ndihmë ekonomike 224 familje nga këto 205 nga sistemi i ndihmës ekonomike dhe 19 nga 6% i bashkisë ,trajtohen 261 persona me aftësi të kufizuar (PAK+ verbëri+ tetraplegjikë)

Biznesi.

Në territorin e Bashkisë Kolonjë ushtrojnë aktivitetin e tyre 325 biznese nga të cilat 233 janë aktivë të biznesit të vogël dhe 65 janë subjekte të biznesit të madh si dhe 27 janë subjekte shtetërore që paguajnë taksat .

Arsimi

Bashkia Kolonjë ka 19 shkolla nga të cilat 3 të arsimit të mesëm, 1 gjimnaz dhe 2 shkolla të mesme të bashkuara , 13 institucione të arsimit parashkollor nga të cilat 2 kopshte në qytetin Ersekë dhe 11 institucione janë në varësi të shkollave përkatëse.

Numri i klasave në total është 92 ,me 967 nxënës dhe 152 mësues dhe edukatore ,nxënës në të mesme 284 ,arsimin 9 vjeçar 499 , dhe 165 fëmijë në kopshte dhe 19 fëmijë në çerdhe.

Mësues në arsimin e mesëm 29, arsimin 9 vjeçar 95 dhe në arsimin parashkollor janë 28 mësues.

Bujqësia dhe Blegtoria.

Sipërfaqja e tokës bujqësore gjithsej figuron 11.210 ha, nga të cilat 7.220 ha tokë arë e ndarë me ligjin 7501 dhe pjesa tjetër 3.990 ha është tokë shtetërore e pa ndarë, nga kjo tokë e mbjellë 5.250 ha, tokë e dhënë me qera 120.7 ha.

Në lidhje me blektorinë në Bashkinë Kolonjë kemi 91.070 krerë gjithsej nga këto gjedhë gjithsej 6.969, të imta 46.651, bletë 11.209, shpendë 24.666 dhe një thundrakë 1.575.

1.2 Çështje kryesore për projektet dhe politikat e bashkisë

Bashkia Kolonjë aktualisht ka një Plan të Përgjithshëm Vendor të miratuar me Vendim të Këshillit nr 29, datë 23.04.2019 për 15 vitet e ardhshme. Ky plan synon zhvillimin, sistemimin dhe përmirësimin e gjendjes ekzistuese të vendbanimit dhe cilësisë së jetesës së banorëve në territorin e Bashkisë.

Finalizimi i Planit të Përgjithshëm Vendor është një ndër arritjet kryesore në fushën e planifikimit të territorit të një bashkie të re, të krijuar pas reformës territoriale dhe me dëshirën e vullnetin për t'iu përgjigjur nevojave dhe kërkesave afatgjata të qytetarëve, si dhe për të përballuar sfidat e një zhvillimi të qëndrueshëm të territorit.

Në lidhje me Projekt-Buxhetin Afatmesëm 2026-2028 kemi përcaktuar transparencën e financave publike e cila preket edhe në strategjinë e menaxhimit të financave publike, vizioni i së cilës është të krijojë një sistem llogaridhënie, disiplinë fiskale dhe efikasitet në administrimin dhe përdorimin e fondeve me qëllim final të zhvillimit ekonomik të njësisë.

Programi Buxhetor Afatmesëm i Bashkisë Kolonjë është hartuar në bazë të programeve të zhvillimit të të gjithë zonës urbane dhe rurale e cila lidhet me funksionet respektive të pushtetit vendor të përcaktuara.

Objektivat e çdo programi janë përcaktuar nga drejtuesit e çdo programi buxhetor. Bazë e prioriteteve tona kanë qenë kërkesat e qytetarëve, problematikat e evidentuara nga stafi i bashkisë, vazhdimësia e punëve, shërbimeve, investimeve të nisura në vitin 2022, vazhduar në buxhetin e vitit 2025, e cila shpreh një lidhje organike të buxhetit të vitit 2025 me PBA-në 2026-2028 por puna e administratës, e administratorëve e drejtuesve të fshatrave si dhe problematikat e dala gjatë dëgjësive të organizuar për buxhetin 2025 dhe PBA-në 2025-2027 na mundësuan problematikat dhe nevojat të cilat u reflektuan në objektiva dhe treguesit e PBA-së 2026-2028.

Hartimi i PBA-së përbën një proces shumë të rëndësishëm për ne, pasi ky dokument siguron mekanizmat e nevojshëm përmes të cilave objektivat tona bëhen të realizueshme, të matshme, të krahasueshme dhe me produktivitet.

Buxheti në qendër të vëmendjes do të ketë qytetarin, rritjen e mirëqënies, rritjen ekonomike, rritjen e aksesit dhe të cilësisë të jetës, duke rritur besimin e dyanshëm, gadishmërinë për të kontribuar, rritjen e cilësisë së rrugëve, mosshpopullimin e zonave rurale, forcimin e jetës kulturore - artistike dhe më kryesorja zhvillimin e turizmit në zonën tonë të cilit i është dhënë një prioritet këto 4 vitet e fundit.

Qëllimet e Hartimit të PBA-së

-Shpërndarja efektive e burimeve.

-Zgjerimi i vizionit të procesit të buxhetimit.

-Parashikim më i mirë buxhetor mbështetur në objektiva dhe prioritete për një periudhë 3-vjeçare, me tregues performance të matshëm dhe të krahasueshëm.

- Rritja e efektivitetit dhe efijencës së shpenzimeve publike.
- Forcimi i disiplinës fiskale.
- Buxhetim i përgjigjshëm gjinor .

Objektivat e hartimit të PBA-së.

- a.Përmirësimi i menaxhimit të shpenzimeve publike dhe rritja e efijencës së përdorimit të fondeve buxhetore është objektivi parësor i PBA-së,në funksion të të cilit angazhimi dhe mbështetja me përgjegjësi të lartë e të gjitha njësive pjesmarrëse ngelet thelbësore në ecurinë e suksesshme të këtij procesi.
- b.Sigurimi i një shpërndarje dhe përdorimi efektiv dhe efijent i burimeve është objektivi nëpërmjet të cilit synohet të arrihet, një kuadër i qëndrueshëm planifikimi afatmesëm brenda të cilit të planifikohen buxhetet vjetore,forcimi i lidhjes mes programeve dhe alokimit të burimeve.

PRIORITETET AFATMESME 2026-2028

Prioritetet afatmesme të reflektuara në PBA 2026-2028 janë mbështetur në kërkesat e qytetarëve dhe programin e Kryetarit të Bashkisë Kolonje dhe PPV.

1. Zhvillimi ekonomik - bujqësor i zonës nëpërmjet përmirësimit të të gjithë infrastrukturës dhe rregullimi i proceseve të përdorimit të tokës drejt nxitjes dhe zhvillimit të qëndrueshëm.
2. Përfundimi i rehabilitimit të rrugëve në qendrat e banuara për rjetësimin e tyre dhe rikualifikimi i qendrave të tyre .
3. Zhvillimi i turizmit në të gjithë territorin e bashkisë.
4. Menaxhimi i integruar i mbetjeve urbane dhe rurale , zgjerimi i sasive të riciklueshme në Landfill.

OBJEKTIVAT AFATMESME 2026-2028 sipas Programeve Buxhetore

Treguesit e performancës për përmbushjen e objektivave

01110 Planifikim, Menaxhim dhe Administrim

1.1 Përmirësimi i stafit të bashkisë dhe kushteve të punës

- Nr i grave në pozicione drejtuese
- % e plotësimit të vendeve të punës me status nëpunësi civil
- % e punonjësve të trajnuar / nr total

1.2 Bashkërendimi i punës ndërmjet stafit të Bashkisë dhe Këshillit Bashkiak për përgatitjen në kohë dhe me cilësi të VKB-ve

- Përgatitja e Projekt-Vendimeve nga stafi i bashkisë brenda afatit (dt 15 e muajit)
- Koordinimi i punës së stafit me kryetarët e fshatrave dhe zgjidhja në kohë e problematikave (në %, problematikat e zgjidhura/totale)

- Transmetimi i të gjitha mbledhjeve të Këshillit Bashkiak online
- Rritja e pjesëmarrjes aktive të qytetarëve në vendimarrje

1.3 Përmirësimi i financave të Bashkisë,

- Përmirësimi i mbledhjes të të ardhurave të veta nga taksat dhe tarifat vendore (Rritja në % viti korrent kundrejt vitit të kaluar i të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore)
- Zbutja e detyrimeve të prapambetura të papaguara dhe moskrijimi i detyrimeve të reja .(në %)

03140 Shërbimet e Policisë Vendore

1.1 Rritja e shërbimeve bashkiake për sigurinë dhe qetësinë publike në komunitet.

- Raste konfliktesh/mosmarrëveshjes të zgjidhura, kundrejt rasteve të telefonuara dhe regjistruara (në%)
- Përmirësimi punës në lidhje me parandalimin dhe manaxhimin e rasteve të konflikteve që kanë motive pronësie dhe kërkojnë ndërhyrjen e policisë Bashkiake
- Menaxhimi i aktiviteteve kulturore sportive nr.aktivitetesh
- Zgjidhje e rasteve të konflikteve,raportin gra/burra (ne %)

03280 Mbrojtja nga Zjarri dhe Mbrojtja Civile

1.1 Mbajtja në gatishmëri dhe përmirësimi i cilësisë së shërbimeve ndaj komunitetit .

- Nr i stacioneve zjarrfikëse
- Reagim më i shpejtë ndaj njoftimeve për zjarre (ndryshimi në sekonda i daljes nga stacioni ditën/natën)
- Rritja e të ardhurave nga tarifat për shërbimin ndaj të tretëve (pajisja me fikse zjarri, etj) (ndryshimi në % viti korrent kundrejt vitit të kaluar)
- Koha e daljes nga stacioni në sekonda (mesatare ditën plus natën)

1.2 Mbulimi me shërbim dhe trajtimi i të gjitha rasteve të fatkeqësive natyrore .

- Rritja e shërbimeve në lidhje me fatkeqësitë natyrore (rritja në % e fondit)
- Forcimi i kapaciteteve për zhvillimin e sistemit të mbrojtjes civile (nr. forcash)

04130 Mbështetja për Zhvillim Ekonomik

1.1 Zhvillimin e turizmit dhe përmirësimi i klimës për të.

- Përmirësimi i shërbimit në sektorin e turizmit (numri i turistëve ,numri personave që marrin informacion në zyra - rritja në %)
- Përmirësimi i shërbimit të promovimit të turizmit. (Eficienca buxhetore e shërbimit) (buxheti alokuar për ngritjen e zyrës / ose përmirësimin e shërbimit të saj ,ndryshimi në %)

- Biznese të reja të subvencionuara, të drejtuara nga gra

04220 Shërbimet Bujqësore, inspektimi, siguria ushqimore dhe mbrojtja e konsumatorëve

1.1 Mbështetje e rritjes së prodhimit bujqësor dhe blegtoral , nëpërmjet rritjes së numrit të inspektimeve dhe kontrolleve në terren , si dhe zgjidhjes së konflikteve pronësore.

- Rritja e sigurisë ushqimore të konsumatori nëpërmjet kontrolleve të kryera (në %)
- Rritja e nr. të konsultimeve , këshillimeve me fermerët dhe saktësimet e pronësisë dhe sigurisë ushqimore.

1.2 Mbrojtja e tokës bujqësore nga gërryerjet dhe përmytjet.

- Rritja e nr të pritave mbrojtëse nga përmytjet dhe gërryerjet e tokës bujqësore

1.3 Dhënia e tokës bujqësore me qera

- Rritja e të ardhurave të përfituara nga dhënia e tokës me qera.

04240 Menaxhimi i infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit

1.1 Përmirësimi i sistemit të ujitjes nëpërmjet pastrimit dhe mirëmbajtjes të kanaleve ujitëse si dhe rritja e sipërfaqeve ujitëse .

- Rritje e sipërfaqes së tokës bujqësore të shfrytëzueshme të mbuluar me ujitje , (në ha)
- Përmirësimi i cilësisë së ujitjes , dhe plotësimi i kërkesave në kohë të fermerëve (në %)
- Rritja e familjeve përfituese nga shërbimi i ujitjes, (numër)

1.2 Përmirësimi i sistemit të kullimit nëpërmjet pastrimit të kanaleve kullues

- Rritje e kanaleve kulluese të pastruar (gjatësi / km)
- Rritja e sipërfaqes e mbuluar me kullim (në ha)
- Rritja e familjeve përfituese nga shërbimi i kullimit, (numër)

1.3 Ruajtja dhe mirëmbajtja në të gjithë elementët e sigurisë së digave

- Rritja e familjeve përfituese nga shërbimi i kullimit, (numër)
- Kontrolle, inspektime dhe ndërhyrje në sigurinë e digave (numër)

04260 Administrimi i pyjeve dhe kullotave

1.1 Administrimi i druve të zjarrit nga parcelat e fondit pyjor në pronësi të bashkisë .

- Rritja e inspektimeve në fondin pyjor .
- Rritja e nr të konstatimeve për prerjet e paligjshme në fondin pyjor
- Përmirësimi i cilësisë së planit të mbarështimit të pyjeve

1.2 Administrimi i sipërfaqeve kullosore në pronësi të bashkisë .

- Përmirësimi i kushteve për kullotje duke ndërtuar lera dhe korita për ujë për blegtorinë.
- Rritja e monitorimit të fondit kullor dhe ndarja e ekonomive kullorë dhe rritja e numrit të kontratave të lidhura .
- Shtimi i nr.të kontrollit dhe inspektimeve në kullota

04520 Rrjeti rrugor rural

1.1 Bashkia siguron akses rrugor të të gjitha njësive administrative të saj tek shërbimet bazike (qendra shëndetësore, shkolla publike etj.)

- Rrugë rurale të mirëmbajtura
- Zgjerimi i rrjetit rrugor urban , çakullim ,kanale anësore

05100 Menaxhimi i mbetjeve

1.1 Përmirësimi i menaxhimit të integruar të mbetjeve urbane.

- Rritja e mbulimit me shërbim (Popullata e mbuluar me shërbim kundrejt totalit të popullatës në njësine administrative (Bashki) në %)
- Rritja e % të mbetjeve që depozitohen në landfill (% ndaj totalit të gjeneruara në vit)
- Sasia e mbetjeve të riciklueshme /totalit të mbetjeve
- Përmirësimi i cilësisë së shërbimit (rritja e frekuencës së mbledhjes të mbetjeve bashkiake në qytet , herë në javë)
- Sasia e mbetjeve të riciklueshme (në ton)
- Frekuenca e grumbullimit dhe transportimit të mbetjeve mesatare (herë/javë) (qytet dhe njësi administrative)

1.2 Zvogëlimi dhe kontrolli i ndotjes së mjedisit ,monitorimi i treguesve të tij ,inspektimi i veprimtarive që ndotin mjedisin.

- Përmirësimi i mbikqyrjes dhe inspektimit të veprimtarive që ndotin mjedisin
- Përmirësimi i mbikqyrjes dhe inspektimit të veprimtarive që ndotin mjedisin (numri i gjobave të vendosura ,rritja në % me vitin e kaluar)

06140 Planifikimi Urban Vendor

1.1 Zhvillimi i komunitetit bazohet në instrumentat e ligjit për planifikimin dhe zhvillimin e territorit.

- Bashkia zhvillon territorin sipas instrumentave ligjore (Inventari i instrumentave të përdorur nga bashkia: - PPV ; Plani detajuar për zonën; Plani sektorial)
- Bashkia akordon leje zhvillimi mbi bazën e PPV (Numri lejeve të miratuara të zhvillimit që përputhen me PPV)
- Efienca e programit të planifikimit urban vendor (Raporti i të ardhurave nga lejet e zhvillimit të miratuara kundrejt totalit të të ardhurave të veta të bashkisë (në %))
- Instrumentat e planifikimit që përdor bashkia

06260 Shërbimet publike vendore

1.1 Bashkia mbështet zgjerimin dhe përmirësimin e shërbimeve publike

- Rritja në % e trotuarëve të rikonstruktuar
- Rritja e sipërfaqeve të gjelbëruara
- Rikualifikim i qendrës së fshatit Mollas duke krijuar hapësira çlodhëse dhe argëtuese
- Rikualifikim Urban i lagjes nr.1 Ersekë

1.2 Përmirësimi i shërbimit të varrezave publike

- Përmirësimi i shërbimit të varrezave publike (mbulimi në %)
- Përmirësimi i shërbimit të varrezave të Dëshmorëve
- Mirëmbajtja e lapidarëve
- Mirëmbajtja e Memorialeve të Martirëve (në m2)

1.3 Sigurimi i ndriçimit në hapësirat publike për të garantuar sigurinë publike në komunitet

- Rritja e numrit të fshatrave të mbuluar me ndriçim
- Përmirësimi i efikasitetit të buxhetit të bashkisë për shërbimin e ndriçimit publik (mijë lekë të shpenzuara për ndriçim / shpenzime operative dhe mirëmbajtje)

08130 Sport dhe argëtim***1.1 Përmirësimi i hapësirave argëtuese dhe sportive.***

- Zgjerimi i strukturave për veprimtari ose ngjarje sportive (korsi vrapimi, pista patinazhi, palestra etj.)
- Shtimi i sipërfaqeve të mirëmbajtura të mjediseve sportive e argëtuese (në m2)

1.2 Realizimi me sukses i kampionatit të futbollit të ekipeve.

- Ndeshjet e zhvilluara nga ekipi i të rriturve, numri
- Ndeshjet e zhvilluara nga ekipet zinxhir, nr për 3 ekipe zinxhir

08220 Trashëgimia kulturore, eventet artistike dhe kulturore***1.1 Përmirësimi i shërbimeve kulturore dhe trashëgimisë kulturore***

- Zhvillimi i krijimtarisë së artit dhe kulturës (ritja e nr. të shfaqjeve artistike)
- Përmirësimi i jetës kulturore në komunitet (ritja e % së spektatorëve pjesëmarrës)
- Rritja e përfituesve të shërbimit (shfaqje artistike - teatër- muze, në %)
- Mirëmbajtja e institucioneve të trashëgimisë kulturore funksionale (numër 3)

09120 Arsimit bazë përfshirë parashkollorin***1.1 Sigurimi i kushteve optimale për përmirësimin e arsimit bazë dhe parashkollor***

- Rritja e efikasitetit buxhetor për përmirësimin e shërbimit arsimor bazë dhe parashkollor

1.2 Aktivitetet argëtuese ,promovuese për socializimin e fëmijëve , ruajtjen dhe trashëgiminë e traditave kulturore-artistike dhe promovimin e talenteve të reja ,për nxënësit e kopshteve dhe arsimit bazë.

- Rritja e nr.të aktiviteteve argëtuese dhe formuese,në %
- Rritja e nr.të talenteve të reja të promovuar
- Ekipe basketboll-volejbolli (raporti vajza /djem)

09230 Arsimi i mesëm i përgjithshëm

1.1 Bashkia ofron kushte për përmirësimin e Arsimit të përgjithshëm të mesëm dhe Konviktit.

- Efiçenca e shërbimit të arsimit të përgjithshëm (mesëm) (mijë lekë të shpenzuara për një nxënës në shkollën e mesme (shpenzime operative dhe mirëmbajtje) kundrejt numrit total të nxënësve në arsimin e mesëm publik)
- Përmirësimi i infrastrukturës të dhomave të fjetjes,dhe ambjenteve të tjera,krijimi i sallës së studimit dhe ambjenteve çlodhëse dhe kreative,zhvillimi i kalendarëve të aktiviteteve,rritja e cilësisë së shërbimeve të ofruara,si rrjedhojë rritjen e numrit të fëmijëve të regjistruar në konvikt.

10430 Përkujdesja Sociale

1.1 Rritja e shërbimeve të personave me ndihmë ekonomike dhe paaftësie

- Mbështetja financiare për familjet që trajtohen me ndihmë ekonomike (nr.familjeve)
- Mbështetja financiare për PAK (nr.personave)
- Pagesë për personat me urdhër mbrojtje ,numër
- Dhënia e ndihmës financiare për fëmijë në familje kujdestar,numër

1.2 Ofrimi i shërbimeve mbështetëse dhe trajtimi i rasteve të dhunës në familje.

- Menaxhimi i rasteve të dhunës (nr.i grave të dhunuara)
- Plotësimi i nevojave për siguri,mirëqënie,shëndetësi dhe arsim për fëmijët në konflikt me ligjin (nr.i fëmijëve)

1.3 Ofrimi i kujdesit dhe sigurisë së fëmijëve nga personeli i çerdhes

- Shërbimet ditore që i ofrohen fëmijëve,
- Numri i çerdheve në bashki ,numër

1.4 Përmirësimi dhe shtimi i shërbimeve të përkujdesjes për moshën e tretë

- Ofrimi i shërbimit në familje për të moshuarit e vetmuar
- Sigurimi i një vakti ushqimor (dreka)

10661 Strehimi social

1.1 Strehim i përshtatshëm dhe i përballueshëm.

- Familje të mbështetura me strehim social kundrejt kërkesave (raporti në %)

- Përmirësimi i strehimit dhe komoditeteve të komunitetit, numri i familjeve që përfitojnë subvencionimin e qirasë)
- Përmirësimi i strehimit dhe komoditeteve të komunitetit, numri i familjeve që përfitojnë banesa sociale me qera

Qëllimet , objektivat dhe produktet janë të analizuar më hollësisht tek dokumenti i instrumentit të planifikimit 2026-2028 për çdo program buxhetor .

1.3 Informacion financiar

1.Burimet e financimit janë :

1. Të ardhurat e veta të bashkisë
2. Transferta e pakushtëzuar
3. Transferta e pakushtëzuar sektoriale

<u>Nr</u>	<u>Emërtim</u>	<u>Viti 2026</u>	<u>Viti 2027</u>	<u>Viti 2028</u>
<u>1</u>	Transferta e pakushtëzuar	205.425	211.486	217.398
<u>2</u>	Transferta sektoriale	153.495	153.495	153.495
<u>3</u>	Të ardhurat e veta	100.117	100.117	100.117
	Shuma	459.037	465.098	471.010

A. Vlerësimi dhe parashikimi afatmesëm i të ardhurave dhe shpenzimeve është mbështetur në nenin 34 të ligjit Nr 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”

Raporti për vlerësimet dhe parashikimet afatmesme të të ardhurave është bazuar mbi realizimet e viteve të fundit dhe të pritshmin e vitit buxhetor ,për këtë qëllim kemi përdorur dhe metodologjinë afatmesme të parashikimit të të ardhurave ,ndryshimet ligjore për paketën fiskale si dhe analizën e risqeve dhe masat për përballimin e tyre.

Të ardhurat e veta të planifikuara për vitin 2026 përbëjnë 21.53% të totalit të burimeve , ose 32.77% të fondit të bashkisë (transfertë e pakushtëzuar + të ardhurat e veta) .

Të ardhurat nga taksat lokale zënë 24.67 % ndaj të ardhurave totale ,Të ardhurat nga tarifat vendore zënë 75.33 % të totalit të të ardhurave ,

Theksojmë së peshën më të madhe të të ardhurave të veta të bashkisë e zënë të ardhurat nga tarifat vendore .

Llogaritja e planit të të ardhurave është mbështetur në llogaritjen e kapacitetit të taksave dhe tarifave, si dhe realizimit në vite të mëparshme,si dhe forcimit të disiplinës fiskale ,dhe politikat e përcaktuara për periudhën në vijim duke u mbështetur në aktet ligjore në fuqi. Parashikimi i të ardhurave në periudhën afatmesme reflekton dhe ndryshimet e paketës fiskale për efekt të ndryshimeve ligjore por edhe për efektin e pjesës debitore nga vitet e mëparshme,arkëtimi i tyre ka influencë në realizimin e të ardhurave.

B. Fondet nga transferata e pakushtëzuar nga viti në vit kanë një trend rritës,përkatesisht në vitin 2026 është rritur me 2.99% në krahasim me vitin 2025, ose në shifër absolute 5.973 mijë lekë . Në vitin 2027 është rritur me 2.95% në krahasim me vitin 2026, ose në shifër absolute 6.061 mijë lekë . Në vitin 2028 është rritur me 2.79% në krahasim me vitin 2027, ose në shifër absolute 5.912 mijë lekë .

C. Transferta e pakushtëzuar sektoriale është e pandryshueshme në tre vitet 2026, 2027, 2028 në vlerën 153.495 mijë lekë.

Totali i Shpenzimeve

Nr	Emërtimi i shpenzimit	Viti 2026	%	Viti 2027	%	Viti 2028	%
1	Shpenzime personeli	300.524	65.47	300.524	64.62	300.524	63.80
2	Shpenzime operative	97.289	21.19	98.603	21.20	104.296	22.14
3	Investime	61.224	13.34	65.971	14.18	66.190	14.06
	Shuma	459.037	100	465.098	100	471.010	100

2. Orientimi afatgjatë i bashkisë nga PPV

2.1 Strategjia e zhvillimit afatgjatë/strategjia territoriale.

Investimet kapitale të parashikuara për tu realizuar në Bashkinë Kolonjë gjatë zbatimit të PPV janë klasifikuar në tre grupe kryesore.

Në lidhje me zhvillimin afatgjatë të Bashkisë Kolonjë ne do të synojmë një zhvillim ekonomik bujqësor të të gjithë zonës të parashikuar në P P V.

Objektivat tona do të synojnë zhvillimin në fushat e mëposhtme:

Objektivat sipas planit strategjik të zhvillimit:

▪ Përmirësimi i infrastrukturës publike

- Mbështetja për infrastrukturën rrugore
- Rivitalizime hapësirash publike/urbane
- Infrastrukturë komunitare
- Shërbime publike
- Infrastrukturë mjedisore
- Infrastrukturë turistike
- Monumente të trashëgimisë kulturore
- Qendra multifunksionale komunitare
- Peizazhin mjedisor

▪ Zhvillimi ekonomik nëpërmjet diversifikimit të aktiviteteve ekonomike

- Përmirësimi i potencialit turistik në hapësirat rurale
- Agroturizëm dhe turizëm rural
- Investime në përmirësimin e shërbimeve tregtare
- Investime në prodhimin e produkteve tradicionale
- Shërbime të tjera ekonomiko - financiare
- Mbështetje për ikubatorë të produkteve rurale tradicionale
- Promovim dhe marketim i zonave rurale

- h. Shërbime transporti
- i. Panairë dhe festa lokale
- **Zhvillim i kapitalit social dhe njerëzor**
 - a. Mbështetje për krijimin e rrjeteve rurale, grupeve lokale të veprimit si dhe shoqërisë civile në zonat rurale
 - b. Trajnim profesional për të rinjtë dhe gratë
 - c. Mbështetje të trashëgimisë kulturore

Në objektivat strategjike të planit parashikohet ,sigurimi i integritetit fizik të territorit të peisazhit historik ,kulturor,natyror dhe urban në të gjithë territorin .Në përputhje me planin e përgjithshëm vendor dhe strategjinë territoriale bashkëngjitur tij gjithashtu dhe me prioritetet e sygjera nga titullari i bashkisë u parashtruan projekte investimesh të shtrira në kohë përkatësisht në vitin 2026,2027,2028.Është parë me prioritet sektori i rrugëve rurale,i shërbimit të pastrimit,rikonstrukcion trotuarësh , ndriçimi LED i përfunduar në 2 qytete dhe me shtrirje dhe në njësitë administrative , zhvillimi i turizmit , rikualifikimi i lagjes nr 1 Ersekë , rikualifikimi urban i fshatit Mollas etj ..

Nëpërmjet implementimit të këtyre projekteve synohet të përmirësohet cilësia e jetës në lokacionet e ndërhyrjes,të promovohet turizmi bazuar në destinacionet e etiketuara ku vizitorët ti gëzohen bukurive natyrore dhe ofertës cilësore e të shumëllojshme turistike dhe të ndërhyhet me efikasitet në kohë dhe në cilesi në veprat inxhinerike (të tipit kanale ujitës,segmente rrugësh rurale etj).

Investimi publik kryhet nga/ose në emër të sektorit publik dhe realizohet nëpërmjet projekteve të investimeve. Projekti i investimit, si pjesë e një Programi të Shpenzimeve Publike, është një grup aktivitetesh të projektuara për të realizuar produkte të caktuara, brenda një afati kohor.

Fakti që mundësitë dhe potenciali financiar është i vogël kushtëzon që efektiviteti dhe efienca e investimeve të përbëjnë një sfidë jashtëzakonisht të rëndësishme si aktuale ashtu dhe në të ardhmen. Nisur nga ky fakt parashikimet , synojnë të evidentojnë dhe të realizojnë një analizë aktuale të gjendjes së investimeve dhe të treguesve të efijencës në veçanti.

Përzgjedhja është bërë bazuar në analizat e detajuar e zonave urbane si vijon :

- Analiza e detajuar e infrastrukturës
- Evidentimi i nevojave për shërbime në bazë të trendeve demografike
- Identifikimi i sipërfaqeve të nevojshme për të realizuar plotësimin e kërkesës për banesa dhe shërbime.

2.2 Sfidat kryesore të zhvillimit

- Në Planin e Përgjithshëm Vendor të cilin e kemi miratuar ka pjesen e vet dhe strategjia e zhvillimit ekonomik të njësisë tonë. Plani Strategjik i Zhvillimit do të synojë një planifikim dhe menaxhim sa më të mirë të financave,burimeve dhe shërbimeve për një periudhë gati 15 vjeçare .Vetë PBA do të jetë pjesë e këtij plani strategjik dhe do të ketë qëllim kryesor në vetvete efektivitetin dhe efijencën e financave vendore,ekonomisë dhe kryerjen e shpenzimeve publike sa më afër qytetarit.

- Lidhja e drejtpërdrejtë midis prioriteteve strategjiko-politike të qeverisë me shpërndarjen e burimeve publike të rakorduara me ato të bashkisë tonë, do të jetë synim për të ardhmen.

- Projekt Buxheti Afatmesëm do të jetë i orientuar mbi bazën e performancës së organit të vetëqeverisjes vendore duke përgatitur kërkesa buxhetore sa më realiste në kuadër

të PBA-së dhe Planit të Përgjithshëm Vendor me qëllim që të sigurojë një shpërndarje të fondeve buxhetore e të reflektojë qellimet e politikës gjatë një periudhe afatmesme 3-vjecare.

- Sfidat kryesore të zhvillimit do të jenë primare në punën tonë të përditshme duke patur si bazë një plan të përgjithshëm sa më realist, gjithëpërfshirës dhe sa më afër komunitetit.

2.3 Plani i shpenzimeve kapitale 2026-2028

Lista e investimeve për vitin 2026

Nr	Emërtimi i investimit	Vlera
1	Prita	1.000
2	Lera	1.000
3	Plan mbarështimi	4.300
4	Rikonstruksion i kanalit ujitës Barmash	3.700
5	Blerje Pajisje pune - aparat saldimi+motorseke	370
6	Blerje Kamioni	4.500
7	Blerje paisjesh kompjuterike	1.500
8	Hartim projektsh për rehabilitim Kanalesh	500
9	Asfaltime	5.000
10	Bashkëfinancim Projektsh	7.000
11	Rikonstruksion i Sheshit Bashki-Muze	5.000
12	Rikonstruksion Pedonale Leskovik	6.200
13	Blerje kosha mbetjesh	3.000
14	Hartim projektsh	1.400
15	Rikonstruksion i Muzeut Ersekë	9.150
16	Rikualifikim i Qendrës Mollas	3.000
17	Blerje materiale për ndërtim pasarele	860
18	Rikonstruksion Konvikti	2.184
19	Blerje sistem për Taksat	860
20	Hartim Projektsh	700
	Total i investimeve	61.224

Lista e investimeve për vitin 2027

Nr	Emërtimi i investimit	Vlera
1	Prita	1.000
2	Lera	1.000
3	Plan mbarështimi	1.300
4	Fidanishte	3.000

5	Rikonstruksion i kanalit ujitës Barmash	1.000
6	Blerje Fadrome	4.500
7	Rikonstruksion i kanalit ujitës Mollas	3.000
8	Mobilim zyrash (tavolina ,karrige)	660
9	Hartim projektsh për rehabilitim Kanalesh	570
10	Asfaltime	5.000
11	Bashkëfinancim Projektsh	7.000
12	Rikonstruksion i Sheshit Bashki-Muze	5.500
13	Rikonstruksion Pedonale Leskovik	6.700
14	Blerje kosha mbetjesh	3.000
15	Rikonstruksioni i Muzeut Ersekë	10.000
16	Rikualifikim i Qendrës Mollas	5.000
17	Blerje materiale për ndërtim pasarele	860
18	Rikonstruksion Konvikti	2.181
19	Blerje sistem për Taksat	4.000
20	Hartim Projektsh	700
	Total i investimeve	65.971

Lista e investimeve për vitin 2028

Nr	Emërtimi i investimit	Vlera
1	Prita	1.000
2	Lera	800
3	Plan mbarështimi	2.000
4	Fidanishte	2.500
5	Rikonstruksion Kanali Furnizues ujitës ,Rezervuari Ersekë	2.500
6	Blerje Pajisje Kompjuterike	2.660
7	Rikonstruksion i kanalit ujitës Mollas	6.000
8	Mobilim zyrash (tavolina ,karrige)	2.000
9	Hartim projektsh për rehabilitim Kanalesh	570
10	Rikonstruksioni Urban Lagjja nr 1 Ersekë	10.000
11	Rikonstruksion Pedonale Leskovik	10.000
12	Blerje kosha mbetjesh	3.000
13	Rikonstruksioni i Muzeut Ersekë	10.000
14	Rikualifikim i Qendrës Mollas	9.200
15	Blerje materiale për ndërtim pasarele	860
16	Rikonstruksion Konvikti	2.400
17	Hartim Projektsh	700
	Total i investimeve	66.190

3. Informacion financiar**3.1 Burimi i të ardhurave**

Treguesit e rritjes ekonomike varen nga rritja e fondeve buxhetore nga të gjitha burimet

3.1.1 Transferta e pakushtëzuar

Transferta e pakushtëzuar e përgjithshme për vitin 2026 është 205.425 mijë lekë

Transferta e pakushtëzuar e përgjithshme për vitin 2027 është 211.486 mijë lekë

Transferta e pakushtëzuar e përgjithshme për vitin 2028 është 217.398 mijë lekë.

3.1.2 Transferta e pakushtëzuar sektoriale

Transferta e pakushtëzuar sektoriale për vitin 2026 është 153.495 mijë lekë

Transferta e pakushtëzuar sektoriale për vitin 2027 është 153.495 mijë lekë

Transferta e pakushtëzuar sektoriale për vitin 2028 është 153.495 mijë lekë.

3.1.3 Të ardhurat e veta

Të ardhurat e veta për vitin 2026 është 100.117 mijë lekë

Të ardhurat e veta për vitin 2027 është 100.117 mijë lekë

Të ardhurat e veta për vitin 2028 është 100.117 mijë lekë.

3.1.4 Totali i Burimeve

- A. Totali i burimeve të financimit për vitin 2026 kap shifrën 459.037 mijë lekë nga të cilat transferta e pakushtëzuar 205.425 mijë lekë , të ardhurat e veta 100.117 mijë lekë transferta e pakushtëzuar sektoriale 153.495 mijë lekë .(nuk janë përfshirë fondet e deleguara)
- B. Totali i burimeve të financimit për vitin 2027 kap shifrën 465.098 mijë lekë nga të cilat transferta e pakushtëzuar 211.486 mijë lekë , të ardhurat e veta 100.117 mijë lekë transferta e pakushtëzuar sektoriale 153.495 mijë lekë
- C. Totali i burimeve të financimit për vitin 2028 kap shifrën 471.010 mijë lekë nga të cilat transferta e pakushtëzuar 217.398 mijë lekë , të ardhurat e veta 100.117 mijë lekë transferta e pakushtëzuar sektoriale 153.495 mijë lekë .

3.2 Shpenzimet

- A. Shpenzimet totale për vitin 2026 kapin shumën 459.037 mijë lekë
 - A.1 Shpenzime për personelin (paga dhe sigurime) kapin shumën 300.524 mijë lekë ose 65.47 % të fondit total.(në fondin e pagave janë përfshirë efektet e rritjes së pagës për të gjitha kategoritë përfituese sipas VKM-ve për ndryshim page).
 - A.2 Shpenzimet operative kapin shumën 97.289 mijë lekë ose 21.19%, nga i cili fondi rezervë emergjencë dhe kontigjencë 4.000 mijë lekë.
 - A.3 Shpenzimet kapitale kapin shumën 61.224 mijë lekë ose 13.34 %.
- B. Për vitin 2027 shpenzimet kapin shumën 465.098 mijë lekë
 - B.1 Shpenzime për personelin (paga dhe sigurime) kapin shumën 300.524 mijë lekë ose 64.62% të fondit total.

B.2 Shpenzimet operative kapin shumën 98.603 mijë lekë ose 21.20%,fondi rezervë emergjencë dhe kontigjencë 4.000 mijë nga fondi i shpenzimeve.

B.3 Shpenzimet kapitale kapin shumën 65.971 mijë lekë ose 14.18%.

C. Për vitin 2028 shpenzimet totale kapin shumën 471.010 mijë lekë

C.1 Shpenzime për personelin (paga dhe sigurime) kapin shumën 300.524 mijë lekë ose 63.80% të fondit total.

C.2 Shpenzimet operative kapin shumën 104.296 mijë lekë ose 22.14%,fondi rezervë emergjencë dhe kontigjencë 4.000 mijë lekë

C.3 Shpenzimet kapitale kapin shumën 66.190 mijë lekë ose 14.06%.

4.4.1 Huamarje (nuk kemi)

4.4.2 Detyrime të prapambetura

Detyrimet e prapambetura prej 13.091 mijë lekë janë planifikuar të shlyhen për vitin 2025.
Jemi një Bashki pa vështirësi financiare dhe kemi ambicjen që fundi i vitit 2025 të na gjejë pa detyrime.

4.4.3 Treguesit Financiarë

000 lekë				
Nr	Burimet e financimit	Viti 2026	Viti 2027	Viti 2028
1	Transferta e Pakushtëzuar	205.425	211.486	217.398
2	Transferta e Pakushtëzuar sektoriale	153.495	153.495	153.495
3	Të ardhurat nga taksat dhe tarifat vendore	100.117	100.117	100.117
TOTALI I BURIMEVE		459.037	465.098	471.010

Tabela përmbledhëse e shpenzimeve totale të bashkisë dhe raporti mbi të ardhurat totale

000 /lekë							
Art	Emërtimi i shpenzimit	Viti 2026	%	Viti 2027	%	Viti 2028	%
600+601	Paga+sigurime shoqërore	300.524	65.47	300.524	64.62	300.524	63.80
602+604+609	Shpenzime Korente	97.289	21.19	98.603	21.20	104.296	22.14
231	Shpenzime për investime	61.224	13.34	65.971	14.18	66.190	14.06
Shuma		459.037	100	465.098	100	471.010	100

4.4.4 Rreziqet financiare dhe fiskale

1. Rreziqet financiare kanë të bëjnë me mosrealizimin e planit të të ardhurave si rezultat i mungesës të një numri të konsiderueshëm familjesh të cilat janë larguar nga bashkia në drejtime të ndryshme dhe pse kanë lejen e banimit në bashkinë tonë ku dhe janë llogaritur detyrimet përkatëse.

2. Shlyerja e detyrimeve të prapambetura dhe krijimi rishtazi i tyre.
3. Mosrealizimi në kohë i procedurave të prokurimit (ripërsëritja e procedurave të prokurimit e cila ndikon drejtpërdrejtë në realizimin në kohë të kontratave)
4. Kriza ekonomike e cila ndikon drejtpërdrejtë në realizimin e planit të të ardhurave të veta, si dhe në realizimin e planit të buxhetit.
5. Mungesa e burimeve njerëzore të kualifikuar.

Projektet e fituara nga hapja e thirrjeve nga Ministritë e linjës FSHZH, IPA 3

1. Për moshat e treta bashkia ka fituar projektin nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqënies Sociale për trajtimin me vakte ushqimore të të moshuarve të vetmuar, kjo dhe si nismë e komisionit të barazisë gjinore dhe aleancës së grave këshilltare.
2. Projekti “Për Përmirësimin e Kushteve të Banesave”, projekt i fituar nga Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit, Drejtoria e Strehimit
3. Projekti “Blerje Fadrome”, projekt i fituar nga Ministria e Mbrojtjes
4. Projekti “Rikonstruksion i terreneve sportive Leskovik”
5. Projekti “Wifi4WB”, bashkëfinancim nga Bashkimi Evropian dhe Qeveria Federale e Republikës së Gjermanisë.

Në relacionin e hartimit të PBA-së janë paraqitur në mënyrë të detajuar të gjitha të dhënat e nevojshme si në shifra ashtu të zbërthyera dhe në qëllime, objektiva, produkte, rezultate e impakte, të matshme dhe të zbatueshme nga të gjithë, po ashtu dhe konkrete e të kuptueshme nga komuniteti të cilëve do u shërbehet me punë, përkushtim e seriozitet duke përmbushur misionin e Bashkisë sonë.

Konc: Specialiste Finance

Eltona Josifi

Konf: Drejtor i Financës

Gentjana Duka

Miratoi: Drejtor i D.C.J.P.P

Origest Lifo

KRYETARI

ERION ISAI

NË MUNGESË DHE ME URDHËR

NËN/KRYETAR

Petro Risto